**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE VORE**
**ZYRA E NOTERISE FIER**
**Notere / Ariana Dodi/**
**Nr.** 2698 **rep. Nr.** 954 **kol.**

KOPJE
Takse Paguar

# KONTRATË SHITJE E KUOTAVE TË KAPITALIT NË SHOQËRINË SH.P.K. "JURVIS"

Ne Fier, sot me daten 10 /12/2013, ne Zyren e Noterise, para meje noteres Ariana Dodi, u paraqiten personalisht :

**PALA SHITESE :**
**JORGEN VANGJEL DASHI,** i datelindjes 04/01/1979, lindur ne Fier dhe banues ne Fier, lagje Sheq i Madh, identifikuar me leternjoftimin ID numer H90104050, i afte per te kryer veprime juridike,
Ketu e me poshte te cilesuar "Shitesi" ose "Pala shitese"

**PALA BLERESE:**
**EVIS NIKOLLAQ DHANA**, i datelindjes 02/02/1980, lindur ne Verri Fier dhe banues ne Fier, Sheq I Madh, identifikuar me leternjoftimin ID numer I00202079H, i afte per te kryer veprime juridike,
Ketu e me poshte, I cilesuar "Bleresi", ose "Pala blerese".

**BAZA LIGJORE: :**
**1-**Ligji 9901 date 14-04-2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare".
**2-**Vendimi nr. 2 date 10 /12/2013 i Asamblese se Ortakeve te shoqerise "JURVIS" SHPK.

**OBJEKTI:** Shitja e kuotave te kapitalit te shoqerise "JURVIS" shpk ne masen 65% , nga ana e ortakut Jorgen Dashi dhe blerja e tyre nga bleresi dhe ortaku Evis Dhana.

**PERMBAJTJA E KONTRATES:**

Kjo shoqeri eshte e rregjistruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me qender ne Fier, lagje "Liri", rruga "Mujo Ulqinaku", me numer NIPT K92626401T, me perfaqesues ligjor Evis Dhana, me aktivitet privat kryesisht ne fushen e ndertimit nepermjet kryerjes se procesit te ndertim-montim-çmontim te konstruksioneve prej derrase ose hekuri dhe armaturave e skelerive te ndryshme etj", me ortake:

1- JORGEN DASHI, pronar i 65% te kuotave te kapitalit te shoqerise.
2- EVIS DHANA, pronar i 35% te kuotave te kapitalit te shoqerise..

Kapitali thelemtar I kesaj shoqerie eshte 100 000 leke (njeqindmije), te ndara ne 100 pjese, ku vlera nominale e nje kuote eshte 1 000 leke.

FIRMA "JURVIS" SH P K DHANA
NIPT K92626401T
ADMINISTRATOR
EVIS DHANA

Jorgen Dashi

Me kete kontrate shitblerje, shitesi Jorgen Dashi, ia shet bleresit Evis Dhana, kuotat qe atij i perkasin ne kapitalin e kesaj shoqerie, ne masen 65%.

Shitja e kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie, ne masen 65%, nga ana e ortakut Jorgen Dashi, sjell humbjen e te drejtes se pronesise se tij mbi keto kuota si pasoje e ketij trasanksioni shitje.

Nga ana e tij bleresi Evis Dhana, eshte plotesisht dakort qe te bleje kuotat e mesiperme, ne masen 65%, pjese takuese kjo e shitesit ne kapitalin themeltar te kesaj shoqerie.

**ÇMIMI I SHITJES: 65 000 leke (gjashtedhjete e pesemije) e barabarte me 65 kuota me vlere nominale 1000 leke secila kuote.**

Kjo vlefte eshte paguar plotesisht para redaktimit te kesaj kontrate, kesh ne dore, jashte zyres se Noterise, pa asnje lloj pretendimi nga palet.

Qysh prej sot bleresi EVIS DHANA, njihet ortak I vetem i shoqerise "JURVIS" shpk dhe pronar i te gjitha kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie ne masen 100%.

**MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE KUOTAVE, PASOJAT JURIDIKE.**

Me nenshkrimin e ketij akti, shitesi, e humbet pronesine e tij ne kuotat e kapitalit te shoqerise, duke mos pasur ne te ardhmen asnje pretendim pronesie mbi keto kuota. Ndersa bleresi EVIS DHANA njihet pronar I ligjshem I ketyre kuotave.

Per çdo detyrim te mundshem te shoqerise "JURVIS" SHPK, ndaj shtetit, deri ne fund te vitit 2011, do te pergjigjen te dy ortaket Jorgen Dashi dhe Evis Dhana, ne raport me pjesen takuese te kapitalit qe eshte percaktuar ne aktin e themelimit te shoqerise. Ndersa cdo detyrim tjeter qe mund te kete shoqeria nga viti 2012 e ne vazhdim, ndaj shtetit ose te treteve, do te jete ne ngarkim te bleresit dhe ortakut EVIS DHANA.

Per sa me siper do te behen ndryshimet perkatese ne Qendren Kombetare te rregjistrimit te Bizneseve.

Ne zbatim te ligjit 9887 date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave Personale", une noterja deklaroj se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjekteve te kesaj kontrate, ne menyre te drejte dhe te ligjshme

Ky akt pasi perpilohet ne kater kopje origjinale me vlere te barabarte, lexohet nga palet dhe gjendet ne perputhje me vullnetin e tyre te lire, nenshkruhet prej tyre ne pranine time.

Une noterja e vertetoj.

**P A L E T**

**PALA SHITESE**

Jorgen Dashi

**PALA BLERESE**

EVIS DHANA

FIRMA "JURVIS"
NIPT K9262640
ADMINISTRAT
EVIS DHAN

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SH.P.K. "JURVIS"**

# V E N D I M

## Nr.2__ DATE 10/12/2013, I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE "JURVIS" SHPK

I marre ne Fier, sot me daten 10/12/2013, nga Asambleja e Ortakeve te shpk "JURVIS", z.JORGEN DASHI dhe EVIS DHANA, ne qendren e shoqerise ne Fier, lagje "Liri" rruga "Mujo Ulqinaku" pall 5-kt, kt.1, ap. 3, perballe lokalit "Zhezha" .

Ne ortaket e shoqerise, pasi shqyrtuam ecurine e derisotme te veprimtarise se shoqerise,

**KONSTATUAM SE:**

Kjo shoqeri eshte e rregjistruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me qender ne Fier, Fier, lagje "Liri" rruga "Mujo Ulqinaku" pall 5-kt, kt.1, ap. 3, perballe lokalit "Zhezha" , me numer NIPT K92626401T, me ortake Jorgen Dashi dhe Evis Dhana dhe me perfaqesues ligjor Evis Dhana. Kjo shoqeri ka aktivitet privat "Operimin ne tregun e ndertimit, nepermjet kryerjes se procesit te ndertim-montim – çmontimit te Konstruksioneve derrase apo hekuri, te armaturave e skelerive qe sherbejne per ndertim".

Duke vleresuar ecurine e derisotme te shoqerise dhe duke pare kerkesat dhe interesat personale, ortaku Jorgen Dashi, ka vendosur largimin e tij nga shoqeria, duke vendosur shitjen e kuotave te kapitalit te shoqerise per pjesen qe atij i perket, (65% TE KUOTAVE OSE 65 KUOTA) ortakut tjeter EVIS DHANA i cili eshte plotesisht dakort qe te bleje keto kuota, duke u njohur pronar i 100% i kuotave te kapitalit te shoqerise.

Per aresyet e permendura, Asambleja e Ortakeve,

**V E N D O S I :**

**1-** Miratimin e shitjes se kuotave te kapitalit te shoqerise "JURVIS" shpk ne masen 65% nga ana e ortakut JORGEN DASHI dhe blerja e tyre nga ortaku dhe bleresi EVIS DHANA.

**2-** Caktimi i z.EVIS DHANA ne detyren e perfaqesuesit ligjor (administratorit) te shoqerise per nje periudhe pesevjecare me te drejte rizgjedhje.

**4-**Te behen ndryshimet perkatese ne rregjistrin tregetar ne QKR.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

EVIS DHANA ______________________          Jorgen Dashi ______________________

FIRMA "JURVIS" SH P K
NIPT K92626401T
ADMINISTRATOR
EVIS DHANA